



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 949/1 Prot.

Tiranë, më 14.08.2023

**V E N D I M**

**Nr. 164, Datë 14.08.2023**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar ankesën nr. 96, datë 24.05.2023, të paraqitur nga Z.Z<sup>1</sup> kundër Ujësjetllës Kanalizime sh.a Fier (UK Fier), në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “moshës<sup>2</sup>”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues, në mes të tjerash informon se: “Unë e nënshkruara Z.Z, bashkëshortja e K.Z, banues në Topojë, Fier, jemi dy pensionistë të vetëm, që më shumë rrimë nëpër spitale se në shtëpi dhe kemi konstatuar se ka pasur mbi faturim nga Ujësjetllës Kanalizime Fier në bazë të kontratës me nr. 3907154, ku figuron që për muajin Nëntor 2020 ka ardhur fatura me vlerën 3250 lekë, si dhe për muajt Janar, Shkurt, Mars 2023, në një vlerë të papërbalueshme nga ne.

*Pretendimin e mbështes në arsyetimin dhe ndërgjegjen e plotë se ndaj nesh po bëhet padrejtësi për shkak të moshës sonë dhe jetesës të vetëm, pasi ne nuk harxhojmë aq shumë ujë sa jemi faturuar. Ujin për gatim dhe për përdorim të pijshëm ne e blejmë pasi aty s'ka as kanalizime dhe uji është tmerrësisht i ndotur, përpos faktit që ujin për përdorim higjiene e përdorim nga një pus që kemi pranë banesës. Atëherë si harxhohet ky ujë? Kam shkuar dhe e kam ngritur si problem dhe në Bashki, po askush nuk e ka marrë seriozisht.*

<sup>1</sup> Z.Z është bashkëshortja e K.Z, i cili ka kontratën me UK Fier, nr. 3907154.

<sup>2</sup> Z.Z ka lindur në vitin 1944 dhe K.Z ka lindur në vitin 1935.

*Nëpërmjet Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Fier, i është dërguar kërkesë për informacion UK Fier në lidhje me rastin tonë (referuar shkresës nr. 77, datë 28.04.2023), por edhe pse drejtuar në mënyrë institucionale nuk ka asnjë përgjigje.*

*Kjo është një padrejtësi dhe vjedhje që bie në kurrizin tonë, se aq pension sa marrim ne nuk na del për ilaçe dhe spitale. Unë kërkoj të paguaj aq sa harxhoj, jo të më vjedhin dhe të më ulin dinjitetin njerëzor”.*

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe UK Fier të verifikojë dhe të marrë masa për zgjidhjen e problematikës.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në bazë të nenit 7, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

**Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:**

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 96, datë 24.05.2023, të paraqitur nga Z.Z, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 647/1, datë 01.06.2023, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe ka kërkuar informacion nga UK Fier, për ankesën e bërë nga Z.Z si dhe ka kërkuar aktet e poshtë cituara:
  - Parashtrime lidhur me pretendimin për diskriminim të Z.Z, nga ana e UK Fier.
  - Kopje të procedurës së shqyrtimit të ankesës dhe të përgjigjes së dhënë ankuses.
  - Informacion mbi historikun e faturimit të ujit gjatë 12 muajve të fundit për Kontratën nr: 3907154, në emër të K.Z.
  - Informacion i hollësishëm mbi mundësitë eksistuese për zgjidhjen e problematikës së mbifaturimit të Z.Z.

Me shkresën nr. 1428/1, datë 16.06.2023, UK Fier, informoi Komisionerin se: *“Abonenti K.Z rezulton abonent i Ujësjetllës Kanalizime Fier sh.a, për furnizim me ujë të pijshëm, me nr. kontrate 3907154. Abonenti faturohet me matje në bazë të konsumit për m<sup>3</sup>.*

*Lidhur me pretendimin e ankuesit se për muajin Nëntor 2020 ka ardhur fatura në vlerën 3250 lekë, si dhe për muajt Janar, Shkurt, Mars 2023, në një vlerë të papërbalueshme dhe se po bëhet një padrejtësi për shkak të moshës dhe jetesës vetëm, pasi nuk harxhojnë aq shumë ujë, është i pabazuar.*

*Vlera e faturës së furnizimit me ujë nuk është një tarifë fikse, por varet në bazë të konsumit mujor në bazë të leximit të ujëmatësit. Ndaj nuk mund të krahasohet vlera e faturës Nëntor 2020 me faturat e muajve Janar, Shkurt, Mars 2023.*

*Bazuar në Konsultimin e Debisë për kontratën nr. 3907154, për abonentin K.Z rezulton se abonenti është faturoar në bazë të konsumit mujor sipas leximit të ujëmatësit.*

*Rezulton se abonenti faturën të cilën e ka kundërshtuar për muajin Mars 2023, e ka paguar, pra e ka pranuar detyrimin. Gjithashtu kjo faturë ka të njëjtën vlerë me faturën e muajit Shkurt 2023. Pra nëse pretendohet se është mbifaturuar dhe kjo vlerë është e papërbalueshme, atëherë përse është paguar nga abonenti?*

*Nga ana e Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Fier sh.a, nga specialistët e terrenit, është bërë verifikimi nga grupi i punës në terren me anë të Procesverbalit të mbajtur në datë 08.06.2023 dhe matësi i abonentit rezulton funksional dhe brenda kushteve teknike.*

*Pra abonenti është faturoar në bazë të konsumit mujor sipas leximit të ujëmatësit i cili rezulton funksional dhe brenda kushteve teknike.*

*Pra abonenti K.Z nuk është mbi faturoar, por është faturoar në bazë të konsumit mujor sipas leximit të ujëmatësit dhe jo për shkak të “moshës”.*

*Lidhur me mundësitë ekzistuese për zgjidhjen e problematikës së mbifaturimit të abonentit K.Z, theksojmë se nuk ka mbifaturim, si dhe pagimi i faturës së konsumit të ujit të pijshëm është detyrim ligjor”.*

Në përgjigje të shkresës së dërguar nga UK Fier, subjekti ankues nëpërmjet procesverbalit të mbajtur në datë 04.07.2023, nga ana e specialistes së zyrës së Komisionerit në Fier, ka informuar se nuk është dakord me përgjigjen e dhënë nga UK Fier.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

#### **A. Lidhur me trajtimin e padrejtë dhe të pafavorshëm të ankueses.**

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me parashikimet ligjore ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e ankueses, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e saj për trajtim të padrejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.*

LMD në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacion në përmbushjen e detyrave të tij”.*

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë që të jepte shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstronohet se viktimi e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në *“shkakun e mbrojtur”*.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i ligjit si një situatë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji.

Në nenin 5, pika 1, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar përcaktohet se: *“1. Ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose*

*procedurë, si dhe çdo formë tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë”.*

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, të cilat japin përkufizimin e diskriminimit, për të arritur në përfundimin se ankuesja është diskriminuar duhet të plotësohen njëkohësisht 3 elementë:

- është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme. Ky trajtim mund të realizohet me veprime ose mosveprime, duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi;
- në krahasim me sesi janë trajtuar ose do të trajtoheshin të tjerët në një situatë të ngjashme;
- dhe arsyeja për këtë trajtim të padrejtë është një nga shkaqet që gëzojnë mbrojtje nga ligji.

Sa më sipër, për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga ankuesja, në radhë të parë Komisioneri do të vlerësojë nëse ajo i është nënshtruar ndonjë trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm, në të drejtën e saj për të përfituar të mira apo shërbime nga ana e UK Fier dhe më konkretisht në lidhje me faturimin e furnizimit me ujë.

*Nga këqyrja e dokumentacionit dhe fakteve rezulton se:*

Referuar Librezës së pagesës së ujit dhe kanalizimeve dhe historikut të faturimit dhe pagesave të abonentit, rezulton se K.Z është abonent i Ujësjellës Kanalizime Fier sh.a, për furnizim me ujë të pijshëm, me nr. kontrate 3907154.

Referuar informacionit të abonentit dhe ankesës së bërë, rezultojnë të dhënat si më poshtë:

Periudha	Konsumi MC	Totali lek	Paguar
Prill 2023	10.0	1202.00	Paguar
Mars 2023	20.0	1826.00	Paguar
Shkurt 2023	20.0	1826.00	X
Janar 2023	13.0	1389.20	X
Dhjetor 2022	7.0	1014.80	Paguar
Nëntor 2022	38.0	2949.20	X
Tetor 2022	10.0	1202.00	Paguar

Subjekti ankues pretendon se është mbifaturuar për periudhën e muajve: nëntor 2022 dhe janar, shkurt, mars 2023.

Në kontekst të shqyrtimit të pretendimit të subjektit ankues, Komisioneri ka analizuar aktet ligjore e nënligjore, të cilat përcaktojnë procedurat për faturimin dhe pagimin e faturës së konsumit të furnizimit me ujë.

Rregullorja e furnizimit me ujë dhe për kanalizimet e miratuar me VKM-në nr. 1304, datë 11.12.2009, “Për miratimin e modelit të Rregullores “Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet

*në zonën e shërbimit të Ujësjellës Kanalizimeve sh.a.*”, është dokumenti kryesor që siguron një marrëdhënie ligjore të drejtë ndërmjet konsumatorëve të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të ujërave të ndotura dhe furnizuesit të këtyre shërbimeve UK sh.a, që vepron në emër të pronarit të aseteve dhe njëkohësisht përgjegjësit ligjor për to, pra Pushteteve Vendore në përbërje të zonës së shërbimit.

Në pikën 2.9 (1), të Vendimit nr. 1304, datë 11.12.2009, të Këshillit të Ministrave “*Për miratimin e modelit të Rregullores “Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të Ujësjellës Kanalizimeve sh.a.”*” parashikohet shprehimisht se: “*Konsumatorë të ujit të pijshëm janë të gjithë personat fizikë dhe juridikë, të cilët konsumojnë ujë të pijshëm dhe janë subjekte të kontratës të furnizimit me ujë me UK Sh.a, në të cilët përfshihen:*

- *Konsumatorët familjarë; - Entet publike; - Entet private.*

*Konsumatorët janë të detyruar të paguajnë për sasinë e ujit të konsumuar sipas mënyrës së dhënies dhe matjes së sasisë (me ose pa ujëmatës) me tarifën e miratuara sipas llojit të tyre nga ERRU”, ndërsa në pikën (2) përcaktohet se: “Furnizimi me ujë të pijshëm nga UK sh.a. për konsumatorët familjarë dhe jofamiljarë shtetërorë ose private, bëhet në bazë të kontratave të shitjes (furnizimit me ujë) që lidhen ndërmjet tyre.....”.*

Në pikën 2.7 (4) të Rregullores, përcaktohet se: “*Konsumatori njofton menjëherë UK sh.a. për ndonjë shqetësim ose difekt të matësit të ujit*”.

Në pikën 3.1 (3) dhe (4) të kësaj Rregulloreje përcaktohet se: “*3. Pagesa e kontratës së lidhjes me FUP do të bëhet vetëm njëherë në bazë të një fature të veçantë, ndërsa tarifa për përdorimin e përhershëm do të bëhet në bazë të faturës mujore të konsumit të ujit të pijshëm. 4. Fatura e konsumit të ujit të pijshëm është titull ekzekutiv në bazë Ligjit nr. 8975, datë 21.11.2002 “Për trajtimin e faturave tatimore të ujit të pijshëm si Titull Ekzekutiv” me ndryshime, i cili mes të tjerave thekson “Fatura tatimore e konsumit të ujit të pijshëm, sipas modelit të përcaktuar nga Ministria e Financave, në bazë të nenit 36 të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, është titull ekzekutiv dhe ngarkohet zyra e përmbarimit për ekzekutimin i tij”.*

Referuar historikut të faturimit dhe pagesave të abonentit K.Z, nga periudha e muajit maj 2020 deri në maj 2023, rezulton se faturimi/konsumi i ujit për familjen K.Z ka qenë i ndryshëm, nga konsumi më i ulët që i përket muajit dhjetor 2022, me 7m<sup>3</sup> (1014.80 lekë) deri në konsumin më të lartë në muajin nëntor 2022, me 38m<sup>3</sup> (2949.20 lekë). Pra rezulton se për çdo muaj konsumi i ujit i faturuar abonentit ka qenë i ndryshëm.

Nga shqyrtimi i praktikës së ndjekur, rezulton se pas marrjes së shkresës së Komisionerit nr. 647/1, datë 01.06.2023, lidhur me ankesën e familjes K.Z, UK Fier ka ngritur grupin e punës për të bërë verifikimin e ankesës. Referuar procesverbalit të protokolluar me nr. 1412, datë 09.06.2023 të mbajtur nga grupi i punës në terren të UK Fier rezulton se: “*I mbajtur me datë 08.06.2023. Sipas ankesës të abonentit K.Z, me numër kontrate 3907154, grupi i punës verifikoi në terren. Matësi është funksional dhe lëshimi aktual është 901 metërkub*”. Pra, rezulton se



matësi është funksional dhe konsumi i ujit është aktual dhe mbifaturimi i pretenduar nuk ka ardhur si rezultat i moshës së familjes K.Z.

Në pikën 4.4 (2) të Rregullores “Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të Ujësjellës Kanalizimeve sh.a.” parashikohet se:

“Në rast se konsumatori nuk është dakord me sasinë e ujit që i është faturuar, ai duhet të paraqesë një kërkesë/ankesë me shkrim me pretendimet përkatëse pranë Zyrës së Marrëdhënieve me Konsumatorin (Z.M.K.) të UK sh.a. deri në fund të muajit pas marrjes së faturës mujore nga ana e tij. Pas këtij afati, pretendimet e këtij lloji të konsumatorit nuk merren në konsideratë. UK sh.a shqyrton kërkesën e paraqitur, brenda 10 ditësh, duke verifikuar sasinë e ujit të faturuar, nëpërmjet krahasimit me matës të kalibruar”.

Nga aktet e administruara, rezulton se subjekti ankues, nuk ka drejtuar ndonjë kërkesë/ankesë sipas parashikimeve të Rregullores të sipërcituar.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.”.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i ligjit si një *situatë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji.*

Neni 20/1 i LMD-së, përcakton qartë detyrimin e personave fizik ose juridik që ofrojnë të mira apo shërbime për publikun, duke cituar shprehimisht:

*“Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato:*

- a) *duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;*
- b) *duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi”.*

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se ankuesja nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e UK Fier.

Në mungesë të një trajtimi të tillë, Komisioneri, arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e UK Fier, kundrejt ankuseses, për shkakun e pretenduar prej saj.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në, nenin 1, nenin 7, pika 1, nenin 20, pika 1 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 9-10, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të Z.Z, për shkak të moshës, nga ana e Ujësjellës Kanalizime sh.a Fier.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**